BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr.2931...Prot.....
Date 14.05.26 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 11.05.2026

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar : Bashkia Maliq

Për shtetasin/en: **Gerhard Telha** me adrese: **Maliq**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shpallje vendimin civil nr. 59, dt.28.01.2025, për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*,pasi dëftesa e komunikimit eshte e pakonfirmuar e pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë ----------
Per : Njesia Administrative/ Bashkinë

_____
(emër, mbiemër, firmë)

STIMP
dt.14.05.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

Nr.Regj.Them. 21001-00567-41-2024 (657/1508) **Nr. Vendimi 41-2025-247 (59)**
Datë Regj. 12.04.2024 **Datë Vendimi 28.01.2025**

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë e përbërë nga:

GJYQTARE – EDA (GJOVARI) DIKO

asistuar nga sekretare gjyqësore Matilda Tasellari, në Korçë sot me datë 28.01.2025, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile me nr.regj. them. 21001-00567-41-2024 (657/1508), datë regj. 12.04.2024, që i përket:

PADITËSE: Elona Telha (Petriti), e bija e Kimet dhe Dile, e datëlindjes 10.08.1983, lindur dhe banuese në Maliq, me adresë: Blloku nr.4, me shtetësi shqiptare, arsim të mesëm, profesioni rrobaqepëse, identifikuar me kartën e identitetit me nr.personal ID. I35810200P, përfaqësuar në gjykim nga avokati i Dhomës së Avokatisë Korçw Hysni Xhelollari, me nr.licence 3331 dhe NIPT. L7411702P, i zgjedhur me deklarim në seancë.

I PADITUR: Gerhard Telha, i biri i Agron dhe Viollca, i datëlindjes 24.06.1982, lindur dhe banues në Maliq, identifikuar me nr.personal ID.I20624232N, në mungesë.

OBJEKTI: Zgjidhjen e martesës ligjore dhe rregullimin e pasojave.

BAZA LIGJORE: Nenet 22, 153, 154/a e vijues të K.Pr.Civile, nenet 132, 138, 146 dhe 153/a e vijues i Kodit të Familjes.

Në përfundim të hetimit gjyqësor, në konkluzionet përfundimtare:

Përfaqësuesi i palës paditëse kërkoi :

datë 19.03.2024 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 238, Njësia Administrative Maliq, Bashkia Maliq. Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi që palët ndërgjyqësa nuk presin fëmijë të tjerë.

Palët ndërgjyqëse janë njohur me dashuri dhe kanë thelluar njohjen e tyre deri në finalizimin e saj në një martesë ligjore në datën 11.03.2003, nga e cila kanë ardhur në jetë dy fëmijët, Elger Telha i datëlindjes 10.07.2005 dhe Esed Telha i datëlindjes 22.09.2010. Në fillim të jetës bashkëshortore, midis palëve ka patur një komunikim dhe marrëdhënie shumë të mirë. Ndërmjet tyre kishte frymë komunikimi dhe mirëkuptimi. Më pas, me kalimin e viteve dhe konkretisht pas ardhjes në jetë të djalit të madh, filluan konfliktet dhe mosmarrëveshjet në çift për shkak të problemeve ekonomike. Mungesa e komunikimit dhe konfliktet e vazhdueshme verbale me njëri - tjetrin çuan në një mungesë të theksuar në ndarjen korrekte të përgjegjësive bashkëshortore dhe prindërore. Aktualisht ata kanë 4 vite që kanë shkëputur marrëdhënien e tyre dhe jetojnë të veçuar fizikisht nga njëri tjetri. Që nga koha e veçimit, dy fëmijët jetojnë me nënën e tyre, paditësen.

Paditësja Elona Telha, në seancën e pajtimit, (pasi në seancë gjyqësore paditësja nuk ishte prezent personalisht dhe u përfaqësua nga avokati i zgjedhur prej saj), ka deklaruar se nga martesa ka patur vështirësi nga ana ekonomike dhe psikologjike. Sipas saj, për shkak të papunësisë të bashkëshortit, mungesës së komunikimit dhe këndvështrimit të ndryshëm për mënyrën e jetesës, ata janë veçuar nga njëri - tjetri prej 4 vitesh dhe martesa e ka humbur qëllimin për të cilin është lidhur dhe ka ngelur thjesht formale. Për këtë arsye paditësja i është drejtuar kësaj gjykate me padinë objekt gjykimi.

Faktet e mësipërme rezultuan nga pohimi gjyqësor i palës paditëse (në mungesë të palës së paditur që kishte dijeni rregullisht për seancën e pajtimit dhe seancën gjyqësore dhe ka refuzuar të paraqitet) si një nga llojet e provave të parashikuar në nenet 214, 281 e vijues te K.Pr.Civile, kjo duke patur parasysh që marrëdhëniet bashkëshortore kanë karakter të ngushtë vetjak.

Vlerësimi i gjykatës:

Për të vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit të saj, gjykata duhet të hetojë lidhur me vullnetin e palëve për zgjidhjen e martesës. Gjykata çmon se për zgjidhjen e çështjes duhet t`i referohet dispozitave të mëposhtme:

Neni 132 i K.Familjes parashikon se: "*Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, të shkeljes së besnikerisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përben shkelje të përseritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët*".

Neni 154 i K. të Familjes parashikon se: "*Zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Kod*".
Sipas nenit 155 të K. të Familjes: "*Para se gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ish-bashkëshort, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija. Në rast se gjykata arrin në konkluzionin se fëmija, përkohësisht, duhet t'i besohet një personi të tretë ose një familjeje kujdestare, duhet të marrë mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë së vendit ku zhvillohet gjykimi*".
Ndërkohë që në nenin 158 të Kodit të Familjes, parashikohet se: "*Prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës e për pasojë të informohet dhe të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. Ai kontribuon në raport me burimet e tij dhe ato të prindit tjetër. E drejta e vizitës dhe e banimit, sipas kushteve të përcaktuara nga gjykata, nuk mund t'i refuzohen, veçse për arsye të rënda që dëmtojnë interesat e fëmijës.*"

Nga analiza e këtyre dispozitave përcaktohet se, prindërit, pavarësisht zgjidhjes së martesës kanë të drejta dhe detyrime të vazhdueshme për fëmijët e tyre, për sa kohë që njërit prej tyre ose të dyve nuk i është hequr e drejta e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, e cila hiqet me vendim gjykate në raste të veçanta dhe të mirëpërcaktuara në ligj. Gjykata vlerëson se pavarësisht nga zgjidhja e martesës së prindërve, lidhja nënë-fëmijë dhe baba-fëmijë duhet të realizohet, funksionojë dhe zhvillohet sa më mirë të jetë e mundur, duke marrë fëmija nga të dy prindërit dashuri, kujdes, afeksion, ndihmë materiale e morale, qetësi emocionale dhe zhvillim normal psikologjik edhe pse i besohet për rritje dhe edukim njërit apo tjetrit prind. Marrëdhëniet pozitive me prindërit, janë përcaktuese në zhvillimin konjiktiv, në formimin e identitetit të fëmijës dhe zhvillimin e personalitetit të tyre. Ajo që duhet pasur parasysh është fakti se interesat dhe nevojat e fëmijës duhet të vihen gjithmonë mbi dëshirat dhe pretendimet e palëve. Gjykata, në vendimin e zgjidhjes së martesës shprehet për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore të dy prindërve në lidhje me fëmijët e tyre, për sa kohë që fëmijët janë të mitur. Të dy prindërit, pavarësisht se fëmijët i lihen për rritje dhe edukim njërit prej prindërve, ata të dy bashkërisht ushtrojnë përgjegjësinë prindërore mbi fëmijën.

Referuar bazës ligjore sa më sipër dhe rrethanave të çështjes objekt gjykimi, gjykata vlerëson se në rastin konkret, fëmija i mitur Esed Telha duhet t'i lihet për rritje dhe edukim nënës të tij, paditëses Elona Telha mbi bazën e argumentimit të mëposhtëm:
Së pari, gjykata çmon se interesi më i lartë i fëmijës duhet të merret për bazë në radhë të parë në dhënien e vendimit lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Në çështjen konkrete, duke patur parasysh interesin më të lartë të fëmjës të mitur si kriter themelor, gjykata vlerëson se fëmija Esed Telha duhet të jetojë me nënën, paditësen për arsye se:

konkludimin për lënien e fëmijës nënës, paditëses, për rritje dhe edukim është mbajtur në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës si kriter parësor.

Lidhur me takimet personale prindërore, në referim të nenit 158 të Kodit të Familjes gjykata çmon që të padituri t'i lihet e drejta për të takuar fëmijën e mitur Esed Telha, javën e parë e të tretë të çdo muaji kalendarik, nga ora 16.00 e ditës së premte deri në orën 16.00 të ditës së dielë ku i padituri do të marrë fëmijën Esed Telha nga banesa e tij dhe do t'a rikthejë sërisht ditën e diel; për periudhën e pushimeve të verës nga data 1 gusht, ora 10.00 deri në datën 15 gusht ora 12.00 të çdo viti kalendarik; në periudhën e pushimeve dimërore nga data 1 janar ora 10.00 deri në datën 5 janar ora 12.00 të çdo viti kalendarik; si dhe në raste ditëlindjesh e festash familjare duke alternuar qëndrimin e fëmijës me të dy prindërit. Gjithashtu, i padituri Gerhard Telha ka të drejtë të ketë komunikime audio-vizive me fëmijën e mitur Esed Telha çdo ditë, prej orës 17.00-18.00 nëse palët nuk bihen dakord ndryshe

Në përcaktimin e takimeve personale prindërore gjykata mban parasysh:

- Moshën e fëmijës i cili është 15 vjeç;
- Faktin që fëmija ndjek arsimin e detyrueshëm, është në klasë të nëntë dhe ka një vijueshmëri të mirë në procesin arsimor – edukativ.
- Rekomandimet e psikologes në raport vlerësimin psikologjik e cila ka sugjeruar se: *"Për sa më sipër, në lidhje me takimin e fëmijës me babain e vet, do të rekomandoja takimet si më poshtë: Respektivisht: Prej ditës së premte, ora 16:00 deri ditën e diel ora 16:00, të javës së parë dhe të tretë të çdo muaji kalendarik. I padituri do të marrë fëmijën Esed Telha nga banesa e tij dhe do ta rikthejë sërish ditën e diel. Për sa i përket pushimeve verore do të rekomandoja: Nga data 01 gusht, ora 10:00 deri në datën 15 gusht, ora 12:00, të çdo viti kalendarik. Për sa i përket pushimeve dimërore do të rekomandoja: Nga data 01 janar, ora 10:00 deri në datën 05 janar, ora 12:00 të çdo viti kalendarik. Duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës, rekomandoj që komunikimet audio-vizive, ndërmjet fëmijës të miturit Esed Telha dhe të padituri, të jenë çdo ditë (duke iu referuar dhe shpeshtësisë së komunikimit të tyre pas veçimit), komunikime në një orar të përshtatshëm, pa cënuar vijueshmërinë e të miturit në proçesin arsimor dhe edukativ.".*

Gjykata vlerëson se meqënëse fëmija i mitur i lihet për rritje dhe edukim paditëses, i padituri duhet të kontribuojë me detyrim ushqimor për fëmijën e tij në bazë të neneve 158/1, 161, 192/b, 197, 210 të Kodit të Familjes. Kjo, pasi gjykata çmon se përcaktimi i detyrimit për ushqim në ngarkim të prindit që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim është në funksion të mbrojtjes të interesit të fëmijës së mitur me qëllim për t'i siguruar mirëqënien ekonomike, materiale.

Në përcaktimin e kontributit për detyrimin ushqimor për fëmijët, gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara në nenin 201/2 të Kodit të Familjes:

- Moshën dhe nevojat e fëmijës për rritje dhe edukim. Konkretisht, fëmija i mitur Esed Telha është 15 vjeç dhe ndjek arsimin e detyrueshëm, është në klasë të nëntë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126, 306 dhe 310 të K.Pr.Civile dhe neneve 132, 143, 161, 197 dhe 201/2 të K.Familjes,

VENDOSI :

1. Pranimin e kërkesëpadisë.
2. Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur në datë 11.03.2003 midis paditëses Elona Telha dhe të paditurit Gerhard Telha, duke marrë paditësja mbiemrin e saj para martese "Petriti".
3. Lënien e fëmijës të mitur Esed Telha për rritje dhe edukim nënës, paditëses Elona Telha.
4. I padituri Gerhard Telha ka të drejtën për të takuar fëmijën e mitur Esed Telha, javën e parë e të tretë të çdo muaji kalendarik, nga ora 16.00 e ditës së premte deri në orën 16.00 të ditës së dielë ku i padituri do të marrë fëmijën Esed Telha nga banesa e tij dhe do t'a rikthejë sërisht ditën e diel; për periudhën e pushimeve të verës nga data 1 gusht, ora 10.00 deri në datën 15 gusht ora 12.00 të çdo viti kalendarik; në periudhën e pushimeve dimërore nga data 1 janar ora 10.00 deri në datën 5 janar ora 12.00 të çdo viti kalendarik; si dhe në raste ditëlindjesh e festash familjare duke alternuar qëndrimin e fëmijës me të dy prindërit.
5. I padituri Gerhard Telha ka të drejtë të ketë komunikime audio-vizive me fëmijën e mitur Esed Telha çdo ditë, prej orës 17.00-18.00 nëse palët nuk bihen dakord ndryshe.
6. Urdhërohet paditësja Elona Telha që t'i krijojë mundësi fëmijës Esed Telha që të realizojë kontaktet audio-vizive me babain e tij, të paditurin Gerhard Telha.
7. Detyrimin e të paditurit Gerhard Telha që të paguajë për fëmijën Esed Telha një detyrim ushqimor në masën 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, duke filluar ky detyrim nga dita e ngritjes së kërkesëpadisë datë 12.04.2024.
8. Një kopje e këtij vendimi të dërgohet në Zyrën e Gjendjes Civile 238, Njësia Administrative Maliq, Bashkia Maliq pas marrjes formë të prerë.
9. Shpenzimet gjyqësore, që konsistojnë në pagesën e tarifës së padisë në masën 3.000 (tre mijë) lekë dhe shpenzimet për aktin e ekspertimit psikologjik në masën 40.000 (dyzet mijë) lekë të parapaguara nga pala paditëse dhe shpenzimet për përfaqësim me avokat të palës paditëse në masën 40.000 (dyzet mijë) lekë, iu ngarkohen të dyja palëve në mënyrë të barabartë.
10. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij ngarkohet shërbimi përmbarimor.
11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.